

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "TERMOHIDRAULIKE"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								



Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Humbjet hidraulike gjatësore varen nga: 1 pikë
- A) Numri i kthesave;
 B) Këndi i kthesave;
 C) Lloji i kthesave;
 D) Gjatësia e tubacionit;
2. Ti-ja është një rakorderi që përdoret: 1 pikë
- A) Për të lidhur dy tuba;
 B) Për të lidhur tre tuba;
 C) Për të lidhur katër tuba;
 D) Për të lidhur pesë tuba;
- 
3. Dendësia e lëngut varet nga: 1 pikë
- A) Forma e enës;
 B) Vëllimi i enës;
 C) Temperatura e lëngut;
 D) Presioni mbi lëng;
4. Nxehtësia transmetohet vetë: 1 pikë
- A) Nga trupi i nxehtë te trupi i ftohtë;
 B) Nga trupi i ftohtë te trupi i nxehtë;
 C) Nga trupi i zi te trupi i bardhë;
 D) Nga trupi i bardhë te trupi i zi;
5. Tubat plastikë të shkarkimit si në figurë lidhen mes tyre: 1 pikë
- A) Me termofuzion;
 B) Me elektrofuzion;
 C) Me gotë me garnicion;
 D) Me saldim;
- 
6. Është element i rrjetit të ujësllësit të brendshëm: 1 pikë
- A) Kolona e dërgimit;
 B) Kolonat e shkarkimit;
 C) Kolona e furnizimit me ujë;
 D) Kolonat e ajrimit;
7. Saraçineskat bëjnë pjesë në grupin e armaturave: 1 pikë
- A) Mbrojtëse;
 B) Komanduese-rregulluese;
 C) Siguruese;
 D) Matëse;
- 
8. Grupi i dushit NUK lidhet me: 1 pikë
- A) Rjetin e ujit të ftohtë;
 B) Rjetin e ujit të ngrohtë;
 C) Rjetin e shkarkimit;
 D) Rjetin e riqarkullimit;
- 

9. Në mjediset për të rritur lavamani vendoset: 1 pikë
- A) 50 cm nga dyshemeja e përfunduar;
 B) 60 cm nga dyshemeja e përfunduar;
 C) 70 cm nga dyshemeja e përfunduar;
 D) 80 cm nga dyshemeja e përfunduar;
10. Radiatorët prodhohen prej: 1 pikë
- A) Bronzi;
 B) Bakri;
 C) Gize;
 D) Gresi.
11. OXHAKU i kaldajës shërben për: 1 pikë
- A) Largimin e produkteve të djegies;
 B) Largimin e nxehtësisë;
 C) Largimin e temperaturës;
 D) Ftohjen e kaldajës ;
12. Pajisja e treguar në figurë është: 1 pikë
- A) Valvola e çajrimit;
 B) Valvola trekahore;
 C) Valvola e moskthimit;
 D) Valvola e sigurisë me sustë;
- 
13. Cili element qarkullon ujin në sistemet e ngrohjes me qarkullim të detyruar? 1 pikë
- A) Ena e zgjerimit;
 B) Radiatori;
 C) Kaldaja;
 D) Elektropompa;
14. Në cilën formë janë shtruar tubat në figurë? 1 pikë
- A) Në formë gjarpërore;
 B) Në formë spirale;
 C) Në formë paralele;
 D) Në formë rrethore;
- 
15. Bideja vendoset: 1 pikë
- A) Përballë klozetës në largësi 20 cm;
 B) Përballë klozetës në largësi 10 cm;
 C) Në krah të klozetës në largësi 20 cm;
 D) Në krah të klozetës në largësi 10 cm;
16. Në një sistem ngrohjeje, valvola tre-kahore ka funksion përzierës kur vendoset: 1 pikë
- A) Pas pompës;
 B) Përpara pompës;
 C) Përpara termostatit;
 D) Pas termostatit;

17. Panelet diellore në një sistem të ngrohjes së kombinuar përdoren: **1 pikë**

- A) Gjatë gjithë vitit;
- B) Vetëm gjatë verës;
- C) Vetëm gjatë dimrit;
- D) Vetëm gjatë pranverës.

18. Për ndërtesa mbi 5 kate, diametri i tubit të hyrjes duhet të jetë: **1 pikë**

- A) $D = 25 \div 32$ mm;
- B) $D = 32 \div 38$ mm;
- C) $D = 38 \div 50$ mm;
- D) $D > 50$ mm;

19. Kolona e shkarkimit të ujrave të përdorura në një ndërtesë montohet: **1 pikë**

- A) Horizontalisht;
- B) Vertikalisht;
- C) Me pjerrësi të caktuar;
- D) Me pjerrësi të pacaktuar;

20. Pozicioni i rekomanduar i vendosjes së radiatorëve është: **1 pikë**


- A) Pranë mureve të jashtme;
- B) Pranë mureve të brendshme;
- C) Mbrapa dyerve;
- D) Të fshehura pas mobiljeve;

21. Në figurë paraqiten dy sisteme ngrohjeje me radiatorë.

a) Emërtoni sistemet nga pikëpamja konstruktive (tubore):

Sistemi A: _____

Sistemi B: _____



2 pikë

b) Cili nga sistemet është më i lehtë për t'u instaluar?

1 pikë

c) Në cilin nga sistemet ngrohja është më e ekuilibruar?

1 pikë

22. Rretho pohimin e saktë në fjalitë e mëposhtme:

4 pikë

- a) Kolektori i kthimit është element i sistemeve të furnizimit me ujë;
- b) Rezervuari shpërndarës është pjesë e ujësjellësit të brendshme ;
- c) Reduktuesi i presionit shërben për të rritur presionin;
- d) Prova hidraulike e ujësjellësit të jashtëm bëhet dy herë;

PO JO

PO JO

PO JO

PO JO

23. Listoni katër elementë të rrjetit të kanalizimit (të jashtëm)

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

24. Tubat prej çeliku mund të lidhen me flanxha:

a) Në cilat raste përdoret lidhja me flanxhë e tubave prej çeliku?

2 pikë

1. _____
2. _____



b) Tregoni arsyen pse shtrëngimi i bulonave duhet të bëhet në mënyrë të kryqëzuar;

1 pikë

c) Cili është qëllimi i vendosjes së hermetizuesve midis flanxhave?

1 pikë

25. Goditja hidraulike është një dukuri e dëmshme e cila dëmton sistemet hidraulike.

a) Tregoni dy faktorë që ndikojnë në goditjen hidraulike (shfaqjen dhe shuarjen e saj)

2 pikë

1. _____
2. _____

b) Tregoni dy masa që merren për zvogëlimin e goditjes hidraulike.

2 pikë

1. _____
2. _____

26. Në impiantet e ngrohjes:

a) Cili është funksioni i pajisjeve të sigurisë?

2 pikë

b) Cili është funksioni i pajisjeve të mbrojtjes?

2 pikë

27. Në pohimet më poshtë vendos e vërtetë (V) ose e gabuar (G). **4 pikë**
- a) Lartësia e oxhakut ka lidhje me diametrin e tij. _____
- b) Përdorimi i pompës qarkulluese në një implant ngrohjeje rrit jetëgjatësinë e kaldajës _____
- c) Pompat qarkulluese montohen vetëm në tubin e dërgimit _____
- d) Në një implant ngrohjeje mund të vendosen një ose më shumë enë zgjerimi _____

28. Analizo pohimet e mëposhtme dhe retho përgjigjen e saktë. **4 pikë**
- a) Pompa qarkulluese me rotor të lagur në sistemet me panele diellore ka nevojë për mirëmbajtje.
PO JO
- b) Valvola e moskthimit bën pjesë në grupin e pajisjeve komanduese rregulluese.
PO JO
- c) Valvola e sigurisë lejon nxjerrjen e ajrit nga sistemi.
PO JO
- d) Valvola e çajrimit vendoset në pikën më të lartë të sistemit të ngrohjes.
PO JO

29. Listoni katër rregulla për montimin e pompës në një rrjet të furnizimit me ujë brenda godinave **4 pikë**
- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

30. Në sistemet e ngrohjes me rrezatim nga dyshemeja:

- a) Cilat janë sistemet kryesore që përdoren për vendosjen e tubave? **2 pikë**
1. _____
2. _____
- b) Tregoni dy forma kryesore të shtrimit të tubave. **2 pikë**
1. _____
2. _____